



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:053234

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05525110

**C.nr.122/21**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË MALISHEVË** / Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtarja Hatixhe Begaj, me zyrtaren ligjore Albane Morina në çështjen juridike të paditëses V.T. nga fshati K., Komuna e Malishevës, të cilën e përfaqëson avokat Agron Kryeziu nga Malisheva, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë - shujtave ditore, vlera e kontestit 894.00 €, jashtë shqyrtimit me datë 29.03.2024, merr këtë:

### **A K T G J Y K I M PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES**

**I. APROVOHET në tërësi** si e bazuar kërkesëpadia e paditëses V. T., nga fshati K. Komuna e Malishevës.

**II. OBLIGOHET** e paditura Komuna e Malishevës - Drejtoria Komunale për Arsim, që në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës - shujtave ditore, paditëses V. T. t’ia kompensojë **shumën në lartësi të përgjithshme prej 894,00 euro, për gjithsej 447 ditë pune**, nga 2 (dy) euro për secilën ditë të prezencës në punë, për shkollat si në vijim, konkretisht për:

- 185 ditë pune në Shkollën e Mesme të Lartë “Lasgush Poradeci” në fshatin Kijevë Komuna e Malishevës, për vitin shkollor 2020/21 (01.02.2020-28.02.2021).
- 118 ditë pune në SHFMU “Kajtaç Ramadani” në fshatin Kijevë, Komuna e Malishevës, për vitin shkollor 2020/2021 (03.04.2021 - 02.07.2021), si dhe 144 ditë pune për vitin shkollor 2021/2022 (27.09.2021- 24.06.2022).

Shumën e lartcekur, detyrohet e paditura që paditësve të iu paguajë me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të filloi të llogaritet që nga dita e paraqitjes së padisë dt.15.03.2021, e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

**II. DETYROHET** e paditura Komuna e Malishevës - Drejtoria Komunale për Arsim që paditësve t’iu kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 125.00 euro, ndërsa REFUZOHET pjesa tjetër e shpenzimeve të procedurës mbi shumën e aprovuar konkretisht në shumën prej 104.00 euro.

## A r s y e t i m

Paditësja V. T. nga fshatin K., Komuna e Malishevës, të cilën e përfaqëson av. Agron Kryeziu, nga Malisheva, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi me dt.15.03.2021, kundër të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me bazë juridike kompensim për shujtat ditore të paraparë me Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë nenin 35 pika 7.

Me dt.26.01.2023 paditësja përmes të autorizuarit të saj av. Agron Kryeziu, ka bërë precizimin e kërkesëpadisë, duke deklaruar që paditësja kërkon të paguhet në emër të shujtave ditore, për periudhën prej 01.02.2020 e deri me datë 21.11.2022 për 447 ditë pune, në shumën e përgjithshme prej 894.00 euro, të gjitha këto me kamatë prej 8% nga dita e parashtrimit të padisë, sipas vërtetimit me nr.3199/23 të datës 25.01.2023, të lëshuara nga SHFMU "Kajtaç Ramadani", në fshatin Kijevë, Komuna e Malishevës, si dhe vërtetimit me nr. prot.365 të datës 03.03.2021, të lëshuara nga Shkolla e Mesme e Lartë "Lasgush Pogradeci", në fshatin Kijevë Komuna e Malishevës, shpenzimet e procedurës i ka kërkuar për përpilimin e padisë në shumën prej 104 euro, për precizim të kërkesëpadisë në shumën prej 104 euro si dhe për taks gjyqësore shumën prej 21 euro.

E paditura përmes përgjigjes së saj në padi të dt.12.10.2021 këtë kërkesë e konsiderojmë si të pa bazuar në fakte dhe në gjendjen faktike sepse kërkesa e palës nuk është e mbështetur në kontratën kolektive të dt.18.04.2017 dhe se kjo shumë e borxhit është parashkruar.

Gjykata të paditurën e ka njoftuar edhe me precizimin e kërkesëpadisë, kështu që e paditura ka dhënë përgjigje në padi –precizim me dt.11.03.2024, ndër të tjera ka theksuar se Komuna e Malishevës, e konteston vlerën e borxhit lidhur me këtë çështje, pasi që kontrata kolektive e arsimit e lidhur në mes të SBASHK dhe MASHT është shkëputur nga MASHT dhe kjo kontratë kolektive tani nuk është në fuqi pasi që palët të cilët e kanë nënshkruar këtë kontratë nuk kanë pasur legjitimitet që ta nënshkruajnë këtë kontratë dhe i ka munguar baza ligjore për nënshkrimin e saj, e gjithë kjo bazuar në njoftimin që ka bërë MASHT për SBASHK me datën 21.11.2022, për shkëputjen e kësaj kontrate, po ashtu MAPL ka bërë njoftim për kryetaret e Komunave me datën 22.11.2022, për shkëputjen e kësaj kontrate nga MASHT për mungesë të bazës ligjore të kësaj kontrate kolektive, kjo kontratë tani nuk është në fuqi, pasi është shkëputur nga MASHT dhe ka qenë e lidhur nga kjo Ministri, Komuna e Malishevës – DKA, e lidhur me këtë çështje kontestuese nuk kanë legjitimitet të palës aktive në këtë procedurë, por këtë legjitimitet tani e ka MASHT, i propozojmë Gjykatës Themelore Gjakovë Dega Malishevë që ta refuzon padinë e paditësve si të pa bazuar ose kjo çështje kontestuese të zhvillohet ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës – MASHT.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Themelësia e kërkesëpadisë del nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, konkretisht nga vërtetimi nr.prot.... i dt.03.03.2021 të lëshuar nga Shkolla e Mesme e Lartë "Lasgush Poradeci" në fshatin Kijevë, vërtetimi me nr.prot.3199/23 i datës 25.01.2023, për paditësen V.T., të lëshuar nga Shkolla Filllore e Mesme e Ulët "Kajtaç Ramadani" fshati Kijevë, Komuna e Malishevës, kontrata e punës me nr. prot.... dt.08.10.2019, përmes të cilave u vërtetua fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura si mësimdhënëse në këtë shkollë, vijueshmëria në punë e paditëses në shkollat e lartcekura për periudhën 01.02.2020-21.11.2022 periudhë kjo për të cilën

paditësja kërkon kompensimin e shujtave të ushqimit për 447 ditë pune, u vërtetua përmes vërtetimeve të lartcekur, e të cilave prova gjykata ia fali besimin e plotë duke u bazuar edhe në nenin 329.1, të LPK-së, në të cilin përcaktohet që *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*, pasi janë lëshuar nga institucionet arsimore të së paditurës.

Në bazë të provave të sipërpërmendura, gjykata vlerëson se nuk është kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura në punë dhe detyra të punës profesionale dhe gjuhës shqipe dhe bibliotekës në Shkollën e Mesme të Lartë “Lasgush Pogradeci” si dhe në Shkollën Filllore e Mesme të Ulët “Kajtaz Ramadani”, në fshatin Kijevë, Komuna e Malishevës, ndërsa kontestues mes palëve ndërgjyqëse rezulton të jetë e drejta në kompensimin në emër të kompensimit të shujtave ditore.

Sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive e Arsimit të Kosovës, e datës 18.04.2017 dhe të datës 22.01.2021, është paraparë se: 35.7 *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*. Sipas dispozitës në fjalë paditëses i takojnë shpenzimet e ushqimit.

Gjykata konsideron se kjo kontratë është marrëveshje e cila bazohet në Ligjin e Punës Nr.03/L-212, neni 90 par. 5 e që përcakton se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*, e që nënkupton detyrimin e punëdhënësit përkatësisht të paditurës për kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë, e njëjta e nënshkruar nga Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që prodhon efekt juridik për punëdhënësit që kanë të punësuar, sepse të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë dhe e paditura është punëdhënëse e paditëses prandaj detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë.

Njëkohësisht, meqenëse u konstatua se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe përkundër faktit se e paditura e ka kontestuar vlerën e borxhit sa i përket kompensimit të mjeteve në emër të shujtave ditore, megjithatë për gjykatën të njëjtat janë të pa kontestueshme, dhe si të tilla janë të besueshme dhe mbi bazën e provave të administruara, konsideron se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit pa shqyrtim të çështjes, sipas dispozitës së nenit 152 të LPK-së në të cilën është përcaktuar se *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundërsht kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”*, e që në këtë rast e paditura përmes përgjigjes në padi nuk i ka kontestuar fare faktet vendimtare përveç që është e kontestuar e drejta e kompensimit të shujtave ditore si e pa bazuar në kontratën kolektive, andaj gjykata duke interpretuar të njëjtën me dispozitat e nenit 396 par.2 të LPK-së, në të cilën përcaktohet se *“Po që se i padituri e konteston kërkesëpadinë, përgjigja në padi duhet t'i përmbajë edhe faktet mbi të cilat i padituri i mbështetet thëniet e tij dhe provat me të cilat provohen faktet e tilla”*, në çështjen konkrete juridike vlerëson se paditura nuk i ka bashkangjitur asnjë provë konkrete parashtrësës së përgjigjes në padi, me të cilat do ti vërtetonte pretendimet e saj.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të paditurës sa i përket legjitimitetit të saj në procedurë, gjykata pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase e paditura lidhur me kompensimin e shujtave ditore obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Kontrata Kolektive, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht në nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave përcaktohet se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”*, ndërsa dispozitat e par.1.2 përcaktohet se *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”*, ndërsa sa i përket pretendimeve për shkëputjen e kontratës kolektive, për gjykatën po ashtu të njëjtat janë të pa bazuara, ngase paditësja sipas padisë kërkon realizimin e të drejtave gjatë periudhës në të cilën ishte në fuqi Kontrata Kolektive.

Si pretendim tjetër të dhënë në përgjigje në padi, se në rastin në fjalë kemi të bëjmë me parashkrim të borxhit, gjykata një pretendim të tillë e refuzon si të pabazuar, për arsye se konform nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e që në rastin konkret paditësi ka kërkuar që t’i kompensohen shpenzimet e ushqimit për periudhat kohore të specifikuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa padinë e ka paraqitur me 15.03.2021, pra brenda afatit prej tre viteve nga kur ka lindur e drejta për kërkesën nga marrëdhënia e punës.

Gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me arsyetimin se për periudhën prej muajit shkurt 2020 deri në muajin shkurt 2021 paditësja ka 185 ditë punë në Shkollën e Mesme Profesionale “Lasgush Poradeci”, prej datës 03.04.2021 - 02.07.2021 paditësja ka 118 ditë pune dhe prej datës 27.09.2021 e deri me datë 24.06.2022 paditësja ka 144 ditë pune në SHFMU “Kajtaç Ramadani” në Kijevë, e që (185+118+144) rezulton të jenë gjithsej 447 dite pune), andaj (447 x 2=894) të njëjtës i takojnë 894 euro në emër të shujtave ditore. Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditëses t’ia paguaj shpenzimet e ushqimit (shujtave) në punë.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së dhe Mendimit Juridike të Gjykatës Supreme të Kosovës për kamatën nr.265/2020 të datës 01.12.2020, ka marr datën e ushtrimit të padisë (data 15.03.2021), e ku lartësia e kamatës vjetor është e definuar 8% deri në pagesën definitive.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, lartësia e shpenzimeve i referohet shumës prej 104 euro për përpilim padie dhe për taksë gjyqësore në shumën prej 21 euro, duke u bazuar në Rregulloren për Tarifën e Odës së Avokatëve numri tarifor 6, si dhe shuma prej 104 euro e kërkuar për precizim të kërkesëpadisë u refuzua nga gjykata duke u bazuar në nenin 453.1 të LPK-së, në të cilën përcaktohet se *“Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t’i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat”*.

Gjykata, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke i'u referuar dispozitës së nenit 152 të LPK-së, e në lidhje me dispozitat e nenit 35 paragrafi 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, dhe dispozitave të nenit 245 par.1 dhe 2, neni 249 par.1 dhe 2 të LMD-së.

**GJYKATA THEMELORË NË GJAKOVË- DEGA NË MALISHEVË**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**C.nr.122/21 dt.29.03.2024**

**Gjyqtarja**  
**Hatixhe Begaj**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa paraqitet nëpërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.